



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR I SHTETIT PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Ditari Mujor

Prill 2022



Investime

Takim me përfaqësues të kompanisë italiane në vendin tonë “La Sia”. Kjo kompani e cila ofron shërbime projektimi inxhinierike arkitektonike si dhe projektim infrastrukturave me përmbajtje të lartë teknologjike, aktualisht operon në Shqipëri me një sektor projektimi ku ka rreth 25 të punësuar.



Sipërmarrës

Sot janë sipërmarrës në fushën e prodhimit të veshjeve të punës por Ylberin dhe Kozmain i njoh që në bankat e fakultetit dhe përkushtimi dhe pasioni i tyre vazhdon të jetë po i njëjti.

Diskutuam mbi perspektivën e të bërit biznes në Shqipëri, trajnimin e punonjësve, si dhe sfidat e punës së përditshme në këto kohëra të vështira.



Partnerët

Me znj. Diana Leka, drejtuese e Këshillit të Investimeve dhe znj. Xaira Shurdha, eksperte e BERZH pranë Këshillit të Investimeve diskutuam për problematikat e adresuara nga biznesi.

Vëmendje e veçantë në bisedë iu kushtua procesit të Konsultimit Publik të akteve nënligjore i cili mundësohet nëpërmjet platformës online “Regjistri Elektronik dhe Njoftimet për Konsultimet Publike”.



Bashkëpunime

Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës është mjedis i cili gjeneron të rinj me pasion për sipërmarrjen dhe ide inovatore në biznes, ndaj ndava një bisedë me Zv. Dekanin Dr. Martin Serreqi ku folëm për kapacitetet që ka ky fakultet, për programin arsimor dhe urat e bashkëpunimit.



EU

Në tryezën e diskutimit dedikuar “Dritares 4 – Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse” të programit IPA të EU. Prioritetet tona për këtë kornizë të cilat kërkojnë mbështetje nga programi IPA 2023 – 2025.

Teksa prezantuam me krenari ecurinë e shpejtë për startupet dhe inovacionin parashtruam nevojën për mbështetje të SME-ve drejt ndërkombëtarizimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR I SHTETIT PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Ditari Mujor

Prill 2022

Konsultime

Një takim shumë interesant me Znj. Herjola Spahiu, Drejtuese Ekzekutive e institucionit financiar NOA diskutuam për mbështetjen e bizneseve të vogla në Shqipëri.

Biseduam për mundësitë e bashkëpunimit midis dy institucioneve me qëllimin e përbashkët të mbështetjes së startup-eve në vend.

Mundësi të reja

Një bisedë mundësish me Znj. Stefania Vizzaccaro dhe Z. Salvatore Ficara nga Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim. Ata e vlerësuan ligjin e startupeve si të shkëlqyer dhe shprehen dëshirën për tu bërë pjesë e procesit, si dhe mbi instrumentet financiare me të cilat mund të mbështetet sipërmarrja dhe inovacioni.

Diaspora

Kënaqësi të takohesha me inxhinierin shqiptar të software-ve në kompaninë e njohur WhatsApp, Aleksandër Bello.

Një i ri plot pasion dhe ide, me të cilin biseduam për angazhimin e të rinjve shqiptarë në Diasporë në zhvillimin teknologjik të vendlindjes, mundësitë dhe kontributin që mund të japin.

Automotive

Në ambientet e kompanisë Lufthansa Industry Solutions në Shqipëri, për të parë e vlerësuar nga afër shërbimet e një prej kompanive më të mëdha të fluturimeve në botë.

Si pjesë e industrisë automotive ndamë vizionin për këtë sektor dhe ftuam për pjesëmarrje në panairin e parë që po organizojmë për këtë industri.

Ekosistemi i startupeve

Ministrja e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes mori pjesë në ceremoninë e ndarjes së çmimeve në edicionin e 10-të i organizuar në partneritet “Albanian ICT Awards” ku u vlerësuan arritjet në teknologji dhe inovacionin e spikatur.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR I SHTETIT PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Ditari Mujor

Prill 2022



Shkollat

Një vizitë shumë simpatike dhe krejtësisht jashtë kornizave sot në ambientet e Ministrisë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes me fëmijët e shkollës 9-vjeçare "Ali Demi" të cilët ishin kureshtarë të shihnin nga afër se si funksionon një institucion.



Ligji SME-ve

Miratuam projektligjin "Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme" i cili hap rrugë zhvillimit dhe mbështetjes së tyre në aspektin teknik dhe financiar.

SME-të janë shtylla e ekonomisë tonë dhe tanimë falë ligjit do të kenë mundësi të shkojnë një hap më tej.



Ndërkombëtarë

Gjatë takimit me përfaqësues të kompanisë "Forschner" në Shqipëri, Z.Ercan Yagmur, Znj.Melih Atabay, Z.Eren Gitmiş mësova lajmin që kompania produktet e të cilit shkojnë për Mercedes Benz do të zhvendoset plotësisht në Shqipëri.



RISI

Takim me Z. Eno Kotmilo dhe Z.Armand Brahaj, përfaqësues të "Rubicon", një kompani e re e formuar në vitin 2020 por me ambicie për të revolucionarizuar tregun e shërbimeve financiare në vend, me licencë evropiane për t'i ofruar shërbim edhe shqiptarëve në diasporë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR I SHTETIT PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Ditari Mujor

Prill 2022



Automotiv Fair Albania


Pak javë na ndajnë nga nisja e edicionit të 1-rë të panairit automotiv në Shqipëri, “Automotive Fair Albania” organizuar bashkërisht nga Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Z. Blendi Gonxhe dhe skuadrat tona proaktive diskutuam detajet e radhës të kësaj vitrine rajonale për sipërmarrjet më novatore në trojet shqipfolëse.



Takimet

Pjesë e takimeve të serisë organizuar nga Protik Innovation Center ndava të reja e ligjit dhe akteve nënligjore për startup-et.

E bashkëndava eventin me Anisa Kaltanji, drejtuese e Postës Shqiptare e cila ofron shumë më shumë sesa ne jemi në dijeni si psh një platformë e-commerce për të gjithë startup-et.



Panairi i punës

Gjatë panairit të punës organizuar nga Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës me përfaqësues të biznesit dhe shoqatave pjesëmarrëse.

Pata kënaqësinë të ndaja me përfaqësuesit dhe studentët mbështetjen që qeveria jep për ekosistemin e startup-eve dhe nxitjen e sipërmarrjeve të reja inovative.



Akademia

Në një bisedë konstruktive me drejtuesit e Fakultetit të Ekonomisë, të Universitetit të Tiranës për të forcuar bashkëpunimin si *triple helix* qeveri, akademi dhe sektor privat, me qëllim kryesor garantimin e ofertës në tregun e punës sipas kërkesave të biznesit.